

V E N D I M
Nr.211, datë 8.5.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.264, DATË
2.8.1991 “PËR SIGURIMET DHE RISIGURIMET”**

Në zbatim të ligjit nr.7506, datë 31.7.1991 “Për Institutin e Sigurimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.264, datë 2.8.1991 “Për sigurimet dhe risigurimet”, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i nenit 1 ndryshohet si vijon:

“Subjektet që administrojnë pronën shtetërore, bëjnë sigurimin e saj për:”

2. Neni 2 të ndryshohet si vijon:

“Instituti i Sigurimeve ka të drejtë të japë risigurim pjesë të portofolit të tij sigurues në të gjitha llojet e veprimtarive siguruese që kryen, kur e gjykon të nevojshme për ruajtjen e aftësisë paguese.”

3. Në nenin 3, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Instituti i Sigurimeve dhe degët e tij kanë të drejtë të marrin agjentë për sigurimet vullnetare dhe /ose të detyrueshme, si dhe ekspertë për të verifikimin dhe vlerësimin e objekteve që do të merren në sigurim, dhe për dëmet e ndodhura në objektet e siguruara”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi